
THE SONG OF SOLOMON

Libri “Kënga e këngëve”

Description

Rezart Beka

Libri Kënga e këngëve

Problemet që shfaqen gjatë studimit të këtij libri janë të shumta dhe disa prej tyre cënojnë drejtpërdrejt besueshmërinë e tij.

1. Autorësia dhe datimi

Autorësia. Libri, në hyrjen e tij (1:1), na siguron se kjo vepër është shkruar e tëra nga vetë mbreti Salomon. Mirëpo RSV e vitit 1952 e përgënjeshtron këtë pretendim duke pohuar: “**Ndërkohë që librit i është dhënë emri i Salomonit, autorët e vërtetë janë të panjohur**” (“The Holy Bible”- Revised Standard Version, Cokesbury 1952, f. 13).

Ky pohim gjen vend edhe në një përkthim të Biblës në italisht, ku në lidhje me autorin e kësaj vepre komentohet: “**Autori është i panjohur**” (“La Sacra Bibbia”, Edizione Paoline 1968, f. 757).

Dom Simon Filipaj, në përkthimin e tij të Biblës në gjuhën shqipe, shkruan gjithashtu: “**Megjithëse në libër pohohet se është kënga e Salomonit, të gjithë pohojnë se autori është i panjohur dhe fshihet nën pseudonimin si të ishte Salomoni. Dihet se ky është një trill letrar, sepse vetë fjalori me shumë aramaizime e fjalë persiane na siguron se duhet të jetë krijuar shumë kohë pas Salomonit**” (“Bibla”, përkthim dhe shtjellim nga Dom Simon Filipaj, vep. e cit., f. 876).

Po përse autori i këtij libri pëlqeu të mos e shfaqë identitetin e tij dhe të fshihet nën pseudonimin e Salomonit? Nga se druhej ai? Përse e kishte kaq të vështirë të shfaqej në publikun e gjërë me personalitetin e tij të vërtetë?

Carlo Ghidelli i përgjigjet kështu kësaj pyetje: “**Bibla saktëson se libri është shkruar nga Salomoni…por ekspertët mendojnë se këtë vepër e ka shkruar rreth shekullit të IV (p.e.s.) një poet i madh dhe i panjohur, i cili, siç ishte zakon në botën e lashtë, duke vendosur veprën nën autorësinë e një personazhi të famshëm, ka dashur t’i jap asaj autoritet më të madh.”**

(Carlo Ghidelli, në “Due Storie d’amore”, vëll. 24 i kolanës “Per Capire la Bibbia”, shtëpia botuese “Ave”, Romë 1994, f. 18).

Pra, autori druhej se mos vepra e tij nuk pranohej nga lexuesi i gjërë dhe duke e vendosur atë nën emrin e Salomonit, që ishte një personazh i shquar në historinë e Izraelit, ai mendonte se do të ishte më e lehtë që libri i tij të pranohej nga masa e gjërë si vepër autoritare, ndaj së cilës duhej treguar nderim.

Datimi. Salomoni ka jetuar aty rreth shekullit të X p.e.s. dhe nëse ky libër do të ishte vepër e tij, siç pretendohet në hyrjen e tekstit (1:1), data e hartimit të këtij libri do të ishte lehtësisht e përcaktueshme.

Mirëpo “**është e pamundur të vendoset data e hartimit të këtij libri në shekullin e X gjatë mbretërimit të Salomonit**” (“The Bible”, New International Version, 1983, f. 1003).

Pas kërkimeve të hollësishme socio-linguisitke, studiuesit arritën në përfundimin se “**këtë vepër e ka shkruar rreth shekullit të IV (p.e.s.) një poet i madh dhe i panjohur.**” (Carlo Ghidelli, vëll. 24 i serisë “Per Capire la Bibbia”, vep. e cit., f. 18. Të shihet edhe: “La Bibbia”- Traduzione Interconfessionale in Lingua Corrente, Torino 1986, f. 933)

Pra, ndryshe nga ajo që pohohet në hyrjen e vetë librit, kjo vepër ka përfunduar rreth gjashtë shekuj pas vdekjes së Salomonit.

2. Interpretimi

“**Problemi më i madh i librit “Kënga e Këngëve” kishte dhe ka lidhje me interpretimin e tij: kemi të bëjmë më një poemë të shenjtë apo profane? A duhet interpretuar sipas kuptimit natyralist, njerëzor, d.m.th. të një dashurie thjesht njerëzore, apo i duhet dhënë një kuptim shpirtëror, i një dashurie më të lartë, si p.sh. asaj hyjnore?**” (“La Sacra Bibbia”, Edizione Paoline 1968, f. 757)”.

Teksti i sipërcituar sjell, pas këtyre fjalëve, një apologji në mbrojtje të tezës së dytë. Kjo është, njëkohësisht, edhe teza që njihet më së shumti në mesin e të krishterëve të thjeshtë. E vërteta qëndron se mbi interpretimin e këtij libri, teologët e krishterë kanë shprehur tre mendime të ndryshme.

Mendimi i parë mbështet interpretimin e kësaj vepre si një poemë kushtuar thjesht dashurisë profane njerëzore. Ky njihet si interpretimi i fjalëpërfjalshëm i veprës.

Mendimi i dytë është në favor të interpretimit simbolik të veprës. Studiuesit që përkrahin këtë mendim, shohin në vargjet e kësaj poeme dashurinë e Hyjit ndaj popullit të zgjedhur, të Krishtit ndaj Kishës, të Shpritit të Shenjtë ndaj Marisë, të Hyjit ndaj njerëzimit e kështu me rradhë.

Mendimi i tretë, i shfaqur kohët e fundit, shkon në drejtim të njohjes së kësaj vepre në kuadrin e një rituali të trilluar nga një kult pagan dhe bashkimi seksual i një femre dhe mashkulli është tipari qendror i saj. Kjo përbën atë që njihet si interpretimi mitologjik i veprës.

Në rradhët e të krishterëve të thjeshtë njihet vetëm forma e dytë e interpretimit të kësaj vepre. Për çdo të krishterë që frekuenton ambjentet kishtare nuk ka dyshim se ky libër duhet komentuar në formë alegorike. Ky besim ushqehet si nga autoritetet klerikale, ashtu edhe nga literatura e vënë në

dispozicion të besimtarëve.

Kjo mënyrë e interpretimit të veprës i ka bazat në shkrimet e teologëve të njohur të krishterë. Forma më e përhapur e intepretimit të saj është ajo që sheh në këtë vepër dashurinë e Krishtit ndaj Kishës së tij.

Disa nga emrat më të njohur që kanë mbështëtur këtë formë interpretimi kanë qenë Hipoliti (234), Origjeni (254), Jeronimi (420), Agustini (430) etj..

Ata që shihnin në këtë vepër bashkimin mistik të shpirtit të besimtarit me Krishtin ose Zotin kanë qënë: Origjeni, Teodoreti (457), Shën Bernardi (1153) Madame J. M. Guyon (1717), M. Stuart (1845) etj..

Lista e interpretimeve alegorike dhe e teologëve që e kanë mbështetur atë mund të zgjatet shumë më tepër.

Siç shihet, kjo mënyrë interpretimi i ka rrënjët në shkrimet e figurave të hershme të Krishtërimit.

Mirëpo forma më e hershme e interpretimit e trajton këtë libër si "**një koleksion të gjerë të më shumë se një duzine këngësh erotike**" ("The Cambridge Annotated Study Bible"- New Revised Standard Version, Notes and references by Howard Clark Kee, Kembrixh 1993, f. 53).

Fakti se interpretimi i fjalëpërfjalshëm është më i hershëm se ai alegorik pranohet si nga studiuesit çifutë, ashtu edhe nga ata të krishterë.

George Fohrer thotë në veprën e tij: "**Interpretimi i natyrshëm i këtij libri si një shprehje e dashurisë erotike ka qenë më i hershmi dhe ka ardhur spontanisht. Në Ant. viii. 7.3., Jozef Flavi e pranon atë si përshkrues të qartë të lavdisë së Salomonit; sipas Mishna Ta'anit 4.8, njerëzit e thjeshtë e kuptonin librin fjalë për fjalë. Mallkimi i Rabbi Akibas për ata që e nënshkruanin atë në shtëpinë e martesës tregon të njejtën gjë për shekullin e dytë. Më vonë, megjithatë, ky interpretim u ndrydh; Teodori i Mopsuestias u dënua pas vdekjes nga Konçili i Pestë i Kostandinopojës (553) për mbështetjen e tij dhe më 1545-ën Kastelio u syrgjynos nga Gjeneva për këtë dhe herezi të tjera.**" (Geoge Fohrer në "Introduction to the Old Testament", vep. e cit., f. 300).

Pra, interpretimi më i hershëm, më i natyrshëm dhe më afër datës së daljes në dritë të këtij libri sheh në këtë poemë një himn kushtuar dashurisë profane njerëzore. Më vonë, ky interpretim u dënua nga Kisha dhe vendin e tij e zuri ai alegorik. Ateherë lind pyetja se përse u ndërmor një veprim i tillë si nga autoritetet çifute, ashtu edhe nga ato të krishtera?

Në një nga përkthimet e Biblës në gjuhën italiane komentohet kështu: "**Hareja e kësaj poezie dashurie, kaq e mangët nga çdo lloj mendimi fetar, ka krijuar shpesh ngurrim tek lexuesit, të cilët kanë pyetur veten se ç'kuptim mund të ketë në Bibël ekzistenca e himneve kushtuar dashurisë tokësore**" ("La Bibbia"- Traduzione Interconfessionale in Lingua Corrente, vep. e cit., f. 933).

Mungesa e mesazhit hyjnor në këtë vepër ka qenë diçka që nuk mund të gëlltitej lehtë sidomos nga çifutët. Fakti se në të nuk përmendet kurrë emri i Hyjit përbënte një problem edhe më të madh. Libri në formën origjinale, në kuptimin e tij të fjalëpërfjalshëm, nuk mund të pranohej si i shenjtë.

Në këto kushte, komentimi alegorik u pa si e vetmja zgjidhje për t'i dhënë veprës një frymë hyjnore dhe

për ta bërë atë pjesë të shkrimeve të shenjta. (Për këtë, të shihet: Robert H. Pfeiffer, “Introduction to the Old Testament”, Harvard University, Harper & Brothers Publisher, Nju Jork 1941, f. 714; si dhe “Introduction to the Old Testament”, nisur nga Ernst Sellin, plotësuar, rishikuar dhe rishkruar nga George Fohrer, vep. e cit., f. 301).

Kjo formë arbitrare interpretimi ka mbizotëruar e pashqetësuar deri në shekullin XVIII, kur doli në pah një këndvështrim tjetër i të kuptuarit të kësaj vepre. Sipas mendimit të ri, kjo vepër ishte “**…një ritual i përshtatur nga një kult pagan, në të cilin bashkimi seksual i një femre dhe mashkulli është tipari qendror**” (“The Cambridge Annotated Study Bible”- New Revised Standard Version, Notes and references by Howard Clark Kee, Kembrixh 1993, f. 53).

Ky mendim, i cili përputhet me interpretimin mitologjik të kësaj vepre, filloi të mbizotërojë në qarqet shkencore që nga shekulli 18 e këtej dhe erdhi si rezultat i studimeve krahasuese në formë e përmbajtje ndërmjet librit “Kënga e Këngëve” dhe shumë himneve aq të përhapura në Lindjen e Mesme, kushtuar dashurisë së perëndive.

Disa nga studiuesit që e mbështesin këtë këndvështrim janë: N. de Jassy (Le Cantique des Cantiques et le mythe d’Osiris-Hetep. Paris, 1914); W. Erbt (Die Hebräer, viti 1906, f. 196-201); T. J. Meek (AJSL 39 [1922] 1-14; dhe në Song of Songs. A Symposium, f. 48-79, Philadelphia, 1924); W. Wittekindt (Das Hohe Lied und siene Beziehungen zum Istarkult, 1926); W. L. Schoff (The Song of Songs. A Symposium, f. 80-120); E. Ebeling (ZDMG 78 [1924] lxviii f.); L. Waterman (JBL 44 [1925] 171-187) etj.

Në ditët tona, “**megjithëse u cilësua si herezi kur u parashtrua nga Teodori i Mopsuestisë (vdekur rreth 428) dhe S. Kastelio (vdekur më 1563), interpretimi i fjalëpërfjalshëm i Këngës së Këngëve ka mbizotëruar përfundimisht, por në dy forma të ndryshme, dramatike dhe lirike**” (Robert H. Pfeiffer në “Introduction to the Old Testament”, vep. e cit., f. 715)

Forma më e hershme e të kuptuarit të kësaj vepre, sikurse pohohet edhe nga R. Pfeiffer, më së fundi u rikthye dhe u bë mbizotëruese në kohët tona dhe vepra, sikurse në të kaluarën e hershme, shihet si dramë apo lirikë dashurie.

Ndër studiuesit që e shohin këtë vepër si dramë dashurie janë të mëposhtmit: “K.F. Stäudlin (1792), Ammon (1795), F.W.C. Umbreit (1820), F. Böttcher (1850), F. Hitzing (1855), C.D. Ginsburg (1857), E. Renan (1860), W. Robertson Smith (1876), J.G. Stickel (1888), S. Oettli (1889), Ch. Bruston (1891), S.R. Driver (1891), E. König (1893), W.F. Adeney (1895), A. Harper (1902), J. W. Rothstein (1911), L. Cicognani (1911), S. Minocchi (1924), G. Pouget dhe J. Guitton (1934) A. Hazan (1936) etj.

R. Pfeiffer, që e përmendëm pak më lart, thotë: “**Dy prirje janë të dukshme ndërmjet atyre që e trajtojnë Këngën e Këngëve si koleksion i pavarur lirikash erotike. Disa e shohin atë si një numër këngësh folklorike të recituara gjatë javës së dasmave, të tjerë nuk e njohin apo e nuk e pranojnë një qëllim të tillë në poezitë në formën e tyre ekzistuese”** (po aty, faqe 716).

Studiuesit që e konsiderojnë këtë libër si një përmbledhje **lirikash dashurie** janë: “J.G. von Herder (1778), J.F. Kleuker (1780), J.C.C. Döpke (1829), L. Zunz (1832), E.J. Magnus (1842), G.R. Noyes (1846), E. Meier (1854), H. Graetz (1871), E. Reuss (1879), D. Castelli (1892), W.W. Baudissin (1901), G. Jakob (1902), P. Haupt (1902, 1907), W. Straerk (1911), R. Dussaund (1919), A. Lods (1920), O. Eissfeld (1936), etj..

Ndërsa studiuesit që e shohin këtë libër si një përmbledhje **këngësh dasmash të kompozuara për festime të ngashme në lashtësi**janë: “J.G. Wetzstein (në commentary of Franz Delitzch, 1875, f. 162-177), B. Stade (Geschichte des Volkes Israel, vëll. II, f. 197 f.), K. Budde (New World, Mars 1894, 56 ff.), E. Riehm (1889-91), C.H. Cornill (1891), E. Kautzch (1896), C. Siegfried (1898), T. K. Cheyne (1899, 1909), M. Jastrow, Jr. (1921), J. A. Bewer (1922), U. Cassuto (GSAI NS. 1 [1925] 23-52), E.J. Googspeed (AJSL 50 [1933-34] 102-104) etj..

Pas kësaj përmbledhjeje të shkurtër të formave, sipas të cilave është interpretuar ky libër, vihet re se interpretimi alegorik i këtij libri është i vonshëm, i pambështetur dhe i pagjasë. Interpretimet e tjera mund të jenë të gjitha të barazvlefshme. Përmbajtja tepër profane e tekstit ka qenë shqetësuese për më të vjetërit dhe përbën problem ende sot për cilindo që mbështet idenë e frymëzimin hyjnor të këtij libri.

Pas këtyre që thamë, mund ta kuptojmë më mirë shqetësimin e ngritur në tekstin e përkthimit biblik në gjuhën italiane që e përmendëm në fillim të kësaj teme, sipas të cilit “**problemi më i madh i librit “Kënga e Këngëve” kishte dhe ka lidhje me interpretimin e tij: kemi të bëjmë më një poemë të shenjtë apo profane?**” (“La Sacra Bibbia”, Edizione Paoline 1968, f. 757)

Date Created
16/10/2014
Author
erasmusi